

 ALBSIG Jetë



MediGuide | Opinion i Dytë Mjekësor (MSO)



MSO | Çfarë është dhe përse është i rëndësishëm

Nëse diagnostikoheni me një gjendje mjekësore, vendimet që merrni pas diagnozës suaj fillestare do të kenë një ndikim të madh në shëndetin tuaj si dhe në cilësinë e jetës në të ardhmen.

Marrja e një opinioni të dytë mjekësor (MSO) mund t'ju japë përgjigje të qarta që ju nevojiten për t'ju dhënë qetësinë dhe besimin për të bërë zgjedhje të informuara. Për shembull, si mund të dini me siguri nëse diagnoza juaj është e saktë? A jeni vënë në dijeni për të gjitha opsonet e trajtimit që keni në dispozicion? Si mund të dini nëse janë marrë parasysh të gjitha opsonet e mundshme të trajtimit?

Një Opinion i Dytë Mjekësor nga MediGuide mund të ndryshojë diagnozën tuaj, planin tuaj të trajtimit dhe të përmirësojë rezultatet shëndetësore. Bazuar në kërkimet më të fundit klinike në qendrat mjekësore lider në botë në rrjetin tonë global, rasti juaj shqyrtohet nga disa nga mendjet më të mira mjekësore në botë.

Duke ju udhëhequr në çdo hap, shërbimi ynë për Opinionin e Dytë Mjekësor është i **shpejtë, efikas** dhe i **disponueshëm**. Ky shërbim është **falas** si pjesë e planit tuaj të sigurimit ose paketës së përfitimeve.



PROCEDURA | Si funksionon

Nëse diagnostikoheni me një gjendje mjekësore..



HAPI 1

Telefono MediGuide .



HAPI 2

MediGuide do t'ju dërgojë një formular për dhënien e pëlqimin të cilin duhet ta firmosni nëpërmjet të cilit Ju na jepni të drejtën për të mbledhur dhe shpërndarë informacionin Tuaj mjekësor.



HAPI 3

Ne kryejmë një komunikim të plotë me Ju përmes telefonit ku shqyrtojmë historinë Tuaj mjekësore dhe gjendjen aktuale. Më pas ne mbledhim të gjitha të dhënat përkatëse mjekësore.



HAPI 4

Bazuar në gjendjen tuaj mjekësore, ne punojmë me ju për të zgjedhur qendrën mjekësore më të përshtatshme ndërkombëtare ose mjekun ekspert nga rrjeti ynë për të shqyrtuar informacionin Tuaj mjekësor. Ju gjithashtu mund të konsultoheni me mjekun Tuaj lokal për të zgjedhur se ku dëshironi të shqyrtohet rasti Juaj.



HAPI

Informacioni Juaj mjekësor rishikohet nga mjeku ekspert ose skuadra e specialistëve në qendrën mjekësore të zgjedhur nga ana Juaj.



HAPI

Brenda 10 ditëve pune nga marrja e informacionit Tuaj mjekësor nga MediGuide, Ju do të merrni një raport gjithëpërfshirës (shqyrtim të detajuar të rastit) për ta konsultuar me mjekun tuaj lokal.

Pasi të konsultoni Opinionin e Dytë Mjekësor, një menaxher i rastit të MediGuide do t'ju kontaktojë për t'ju ndihmuar të orientoheni në sistemin e kujdesit shëndetësor gjatë fazës së trajtimit mjekësor.

REZULTATET | Çfarë tregojnë të dhënat

Një diagnozë e gabuar ose një plan trajtimit i gabuar çon në një rezultat të keq, i cili në disa raste mund të jetë kërcënues për jetën.

Një Opinion i Dytë Mjekësor nga MediGuide ofron akses në informacionin më të fundit mjekësor nga specialistë kryesorë mjekësorë nga sbjectet mjekësore më të njoitura në botë. Ky lloj aksesi ul ndjeshëm potencialin për diagnoza të gabuara dhe trajtime të pasakta.

Duke analizuar të dhënat, Ne e dimë se shërbimi ynë i Opinionit të Dytë Mjeksësor (MSO), është përkthyer në një cilësi të lartë klinike dhe me rezultate më pozitive mjekësore për anëtarët tanë. Vitet e fundit, ne kemi parë një rritje dramatike të numrit të rasteve kur procedurat e panevojshme, rreziqet dhe komplikimet shoqëruese janëshmangur për shkak të një diagnoze të ndryshme ose të ndërgjegjësimit për një gamë më të gjerë opsjonesh ose opsiione më të përshtatshme.



Për të marrë një Opinion të Dytë Mjekësor gjendja mjekësore duhet të jetë kërcënuese për jetën?

Jo. Shumica e rasteve për Opinion të Dytë Mjekësor vijnë nga kushte serioze ose kërcënuese për jetën, por ju mund të merrni një Opinion të Dytë Mjekësor për pothuajse çdo gjendje mjekësore.

Në brendësi | Pyetje të shpeshta

A do të ofendohet mjeku im lokal nëse kërkoj një opinion të dytë mjekësor?

Një Opinion i Dytë Mjekësor MSO nuk ka të bëjë me hamendjet e mjekut tuaj. Shumica e mjekëve pajtohen se një opinion i dytë mjekësor shton vlerë, duke ofruar një pamje të plotë të gjendjes suaj shëndetësore dhe opsioneve të mundshme të trajtimit.

Cilët janë vlerësuesit për Opinionin e Dytë Mjekësor të MediGuide?

Rasti juaj shqyrtohet nga specialistë në qendrat mjekësore të përgjedhura për përparimet e tyre kërkimore mjekësore, trajtimet më të fundit dhe cilësinë e përgjithshme të rezultateve të tyre klinike.

A është e mbuluar familja ime?

Po. Bashkëshorti ose partneri juaj dhe fëmijët tuaj mbulohen me kusht që plani juaj i sigurimit ose përfitimi të mbulojë familjen tuaj.

Po në lidhje me privatësinë dhe sigurinë e të dhënave të mia mjekësore?

Të gjitha komunikimet dhe korrespondenca midis Jush, MediGuide dhe Qëndrës Mjekësore (WLMC) tuaj të zgjedhur mbeten konfidenciale. Të gjitha transferimet elektronike të informacioneve tuaja mjekësore janë të dhëna të mbrojtura .



**KONTAKTONI | Vetëm një telefonatë
për të filluar**

+1(302) 425 5900
info@mediguide.com
www.medi-guide.com

4550 Linden Hill Road, Ste 103
Wilmington, DE 19808, USA

+355 42254664
info@albsig-jete.al
www.albsig-jete.al

Rruga e Barrikadave, Albsig HQ,
1001 Tiranë



#albsig.jete



www.linkedin.com/company/medi-guide-medical-second-opinion